



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:909353

Datë: 06.05.2024

Numri i dokumentit: 05733196

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA DEÇAN, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtar Fatmir Dobraj dhe Bashkëpunëtorin Profesional Arijanit Balaj , në çështjen juridike-kontestimore të paditësit F..... O..... nga Komuna e Deçanit, të cilin e përfaqëson av. I.... O..... nga Deçani , kundër të paditurës Q..... e M..... F..... në D....., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i sajë H.... R..... Baza juridike: kompensimit e dëmit jo-material dhe material, Vlera e kontestit: 58.150.00 (pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë), në Seancën e Shqyrtimit Kryesor të mbajtur me datë 24/04/2024, në prani të autorizuarit të paditëse dhe autorizuarit të paditurit, e të përpiluar me datë: 06/05/2024, bie këtë:

AKTGJYKIM

APROVOHET PJESERISHTË, si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F..... O..... nga K..... e D.....

DETYROHET e paditura Q..... e M..... F..... D....., qe paditësit ne emër të kompensimit të dëmit:

a) Për dëmin jomaterial

Kompensim (satisfaksion) ne emër të dhimbjeve trupore të përjetuara per të gjitha llojet, Shumen prej 5100 (peshmije e njeqindë euro).

Kompensim (satisfaksion) për frikën për të gjitha llojet shumën prej 4900 (katërmijë e nentëqindë euro)

Zhdëmtim (Satisfaksion) në emër të shëmtimit shumën prej 4.200(katër mijë e dyqind euro).

Zvogëlim Aktivitetit jetësor shumën prej 4700 (katërmijë e shtatëqindë euro)

Për Dëmin material:

Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 1100 (njëmijë e njeqindë euro)

Shpenzimet për Shërim shumën prej 5400 (peshmije e katerqindë euro)

Në emër të Ndihmës së personit të tretë shumën prej 1100 (njëmijë e njeqindë euro)

Ne shumën totale prej 26,500.00 (njëzet e gjashtëmijë pesqindë euro).

Respektivisht shumën e përgjithshme për dëmin jo material dhe material shumat e gjykuara të specifikuar si në piken I,II të dispozitivit të këtij aktgjykimi tia paguaj me kamatë siç e paguajnë bankat afaristë në Kosovë për mjete të deponuara të qytetareve pa destinim të caktuar dhe afarizem sipas normes 6% ne vitë, duke filluar nga dt 06.05.2024 e gjer në pagesën definitive. Duke filluar ne afate prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

OBLIGOHET e paditura që t'ia paguaj paditësve shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 4,850€, € në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim e përmbarimit me dhunë.

III. REFUZOHET pjesërisht pjesa tjetër e padis dhe kërkesës padis përtej shumës së gjykuar: më të cilën ka kërkuar që të **Detyrohet** e paditura Qendra e Mjekësisë Familjare në Deçan, që paditëses ne emër te kompensimit të demit:

Për Dëmin jo material:

Kompensim (satisfaksion) ne emër te dhimbjeve trupore te përjetuara per te gjitha llojet, shumen prej 1900 (njëmijë e nentëqindë euro).

Kompensim (satisfaksion) për frikën për të gjitha llojet shumën prej 2100 (dymijë e njeqindë euro)

Zhdëmtim (Satisfaksion) në emër të shëmtimit shumën prej 5.800(pesëmijë e tetëqind euro).

Zvogëlim Aktivitetit jetësor shumën prej 2.300 (dymijë e treqindë euro)

Për Dëmin material:

Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 1000 (njëmijë euro)

Shpenzimet për Shërim shumën prej 1350 (njëmijë treqind e pesdhjetë euro)

Në emër të Ndihmës së personit të tretë shumën prej 700 (shtatëqindë euro)

Zvoglim i përgjithshëm i aftësisë punës në shum prej 16500(gjashtëmdhjet mije e pesqindë euro)

Për Rentën e kapitalizuar në shumën prej 14,092.31 (katërmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy euro e tridhjetë e një cent)me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 16/04/2024(data e marrjes së këtij aktgjykimit), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 20/02/20213, kundër të paditurës Q..... e M..... F..... në D....., për kompensim dëmi.të precizuar me datën.22.01.2024. I Autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: mbesë pranë padisë dhe kërkesës se saj respektivisht precizimit të kërkesëpadisë të dorëzuar me dt. 21/03/2024 duke theksuar se nga provat e administruara gjatë seancave është vërtetuar në tërësi baza juridike e kerkesë padisë, ndersa lartësia e kerkese së padisë së precizuar është proporcionale me ekspertet mjekësor, andaj propozojmë gjykatës që të njëjtën të aprovojë ne tërësi.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar specifikuar.

Përfaqësuesi i të paditurës gjatë shqyrtimit gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e kundërshtojmë bazën juridike të kërkesë padisë , lidhur me precizimin e berë , Andaj kërkojmë nga gjykata që padinë dhe kërkesën e saj ta refuzoje si të bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka administruar me këto prova: Lexohet raporti i qendrës klinike universitare i Kosovës, klinika e neurologjisë me nr. 457-10 e

dt.30.04.2010 me prova përcjellëse të përshkruara me sistemin sensitiv NCV të renditura 1-6 faqe, raporti i qendrës klinike universitare i Kosovës, klinika e neurologjisë me nr. 571-10 e.dt. 01.06.2010.Me raporte specialistike 1-2 faqe, raporti i qendrës klinike universitare i Kosovës, klinika e neurologjisë kabineti për elektromiografi me nr. 972-10 e dt. 08.09.2010, me prova përcjellëse të përshkruara me sistemin sensitiv NCV, 1-15 faqe, raporti i spitalit regional ne Peje me nr. të protokollit 4706 i dt. 22.04.2010, 1-2 faqe, raporti specialistik euromet i dt. 05.07.2010 dr. Habib Jakupi, me raporte konsulta 1-4 fq, fatura me nr. 17128 ne vlere prej 200 euro i dt.08.09.2010, fatura e barnatores Fati me nr.208 ne vlere prek 21 euro, dhe ne vlerë prej20 euro, fatura e barnatores Fati me nr.248 ne vlere prek 40 euro, dhe kuponi fiskal ne vlere prej 15.05. Euro 20 euro.faturat e renditura sipas regjistrave të shenjezuar me nr. Të kuq të fq. 40 deri ne fq. 47, ekspertiza e mjekësisë e dt.20. October. 2015 Dr. Flamur Blakaj, Naim Ukaj dhe Kamber Zeqiraj, Aktgjykimi me nr. P.nr. 300-2012 i DT. 16.01.2013. Plotësim ekspertiza mjekësore e dt. 19.07.2023 e nxerrur nga Flamur Blakaj, Naim Ukaj, dhe Kambe Zeqiraj me sqarim si ne proces verbalin e dt. 24.10.2023, ekspertiza mjekësore nga lëmia e mjekësisë ligjore e nxerrur nga ekspertet Flamur Blakaj, Naim Ukaj dhe Kamber Zeqiraj,sqarim sipas proces verbalit te dt. 20.12.2023, ekspertiza financiare e dt. 11.03.2024, e nxerrur nga eksperti Uke Sadiku,me sqarim si ne proces verbalin e dt. 20.03.2024, Çertifikata me nr. 376. Departamenti i pensioneve i dt. 03.04.2024, vërtetimi i Q.P.S. me nr. 04-2024 i dt. 06.03.2024.

Pasi administrimit të provave dhe vlerësimit nga ana e Gjykatës, të secilës provë veç e veç , e në lidhshmëri me njëra- tjetrën, çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje, si dhe duke mbështetur dispozitën e nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata murr parasysh edhe sugjerimet e dhëna nga Gjykata e Apelit me numër Ac.nr 728/2018 e dt.12/04/2021

Faktet.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se paditësi gjatë injeksionit kishte pësuar lëndimet trupore raportin e Spitalit Regjional në Pejë të dt.22/04/2010 me numër 4706/2010, nuk ishte kontestuese se punëtori i cili ishte duke punuar në atë kohë tek e paditura kishte dhëne injeksionin dhe po ashtu në shkresat e lendes nuk ishte kontestuese se Ganimete Thaqi kishte pranuar fajësinë siç vërehet me aktgjykimin me numë P.nr 300/2012 dt.16/01/2023.dhe i plotfuqishëm ne datën 29.03.2013.

Për gjykatën ishte kontestuese përgjegjësia për dëmin dhe lartësia e kompensimit.

Gjykata në rastin e vlerësimit të përgjegjësisë kishte nxjerrur ekspertizën nga tre ekspertet Dr. Flamur Blakaj, Dr. Naim Ukaj dhe Dr. Kamber Zeqiraj të cilët në ekspertizën e tyre kishin deklaruar se paditësit kishte pësuar këto lëndime: Lendimi i nervit peroneus të djathë pas injeksionit, Vendi i dhënies se injeksionit është në kuadratin e sipërm të brendshëm, Lesion Aksonal të nervit ishiadik djathtës me pasojë parezen e nervit peroneal, Pareze të nervit peroneus të kembës së djathë. Në konstatimin e tyre ndertjera kanë deklaruar se nuk e përjashtojnë mundësin e shkaktimit të dëmtimit të nervit ishiadik pas dhënies së injeksionit, me pasojë perezën e nervit peroneus të këmbës së djathtë dhe si i tillë ky dëmtim bënë pjesë në dëmtime të renda trupore. Si dhe në procesverbalin e dt.24/10/2023 Dr.Flamur Blakaj si anëtar i grupit të eksperteve, ka mbetur në tërësi pranë ekspertizës me shkrim të paraqitur në këtë gjykatë.

Lidhur me zvogëlimin e aktivitetit punues nga ekspertet Dr.Flamur Blakaj , Dr. Naim Ukaj , dhe Dr. Kamber Zeqiraj Neurolog , të cilët në ekspertizën e përpiluar me shkrim kanë konstatuar se kanë pësuar këto lëndime : Dëmtim (PAREZE) i nervit peroneus të djathë, i konstatuar që në raportin e parë të spitalit të Pejës me dt. 22/04/2010 dhe i konfirmuar EMG të vazhdueshme deri në raportin e fundit, dt.26/06/2023. Dëmtime të Renda trupore, Jo të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit dhe me pasoja të përhershme të shëndetit. Në çastin e lëndimit , gjatë intervenimit mjekesorë , gjatë terapisë mjekesore dhe gjatë periudhës së përmisimit , i dëmtuari ka përjetuar këto dhimbje fizike : Intezitetit posaçërisht të lart prej ½ orëve , intezitetit të lartë 2 dit , intezitetit të mesëm 30 ditë , intezitetit i ulët ende her pas here . Të dëmtuarit i është duhur: Ndihma dhe kujdesi i personit tjetër 3 muaj, ushqimi i përforcuar 3 muaj, shërim klimatik-fizioterapeutik 80 dit.

Shëmtim apo çrregullim (prishje) të aspektit estetik: Shkalla shumë e ulët.

Zvogëlim i përgjithshëm i aktivitetit jetësor në 10 % , Zvogëlim aktivitetit të punës në vlerë prej 10 % ku nder të tjera për aftësinë punuese kanë deklaruar se “Pasoja e dëmtimeve të cilat shoqërohen me paaftësi punuese deri 30 % nuk cenon aftësinë mbetur punuese për përmbushjen e detyrimeve të punës, sepse “Organizimi i njeriut nëpërmjet mekanizmave të tij kompensatore si dhe angazhimit shtesë arrin ta plotësoj këtë paaftësi”. Ndersa në seancën e datës 20/12/2023 eksperti Dr. Flamur Blakaj ka mbetur pranë ekspertizës së përpiluar me shkrim .Pasiqe e vertetoje bazën.

Gjykata lidhur me shumat e kërkuara ka nxjerrur ekspertizën financiare të dhenë me shkrim nga eksperti Ukë Sadiku i cili ne mendimin e tij ka deklaruar se : Përlllogaritja sipas kësaj lende për rentën e arritur (fitimit të Humbur) dhe rentën vijuese të kapitalizuar për paditësin Fitim Osaj nga Deçanit , është kryer konform aktvendimit të Gjykatës , dhe se renta e kapitalizuar e përlllogaritur është si vijon : Fitimin e Humbur , Renta e arritur periudhën 01/06/2014 deri me dt.31/12/2023 është 4,485.0 euro ,ndersa kamata ne rentën e arritur gjerë me dt.29/02/2024 është 1,794.75 euro ,në total shumë prej 6,279.73 euro .

Renta e kapitalizuar për periudhën 01/01/2024-14/05/2061 është 7,812.58 euro , ndersa ne tërësi renta vijuese mujore në rast mos pagesës nder të tjera renta e kapitalizuar është 13.0 trembëdhjetë euro në muaj .Në seancën e datës 20/03/2024 eksperti Ukë Sadiku ka mbetur pranë ekspertizës së përpiluar me shkrim .

Gjykata ne bazë të vërtetimeve si Çertifikata me numër 376 e dt.08/03/2024 nga Departamenti i Pensioneve vërteton e paditësi nuk e gëzon asnjë pension pranë këtij institucioni, ndersa me deklaratën e lëshuar nga Ministria e Financave me numër 35/34 e dt.12/03/2024 ku konstatohet se paditësi nuk është në marrëdhënie Pune, me vendimin numër 04/2024 leshuar nga Qendra për Punë Sociale vërteton se paditësi nuk është shfrytëzues i ndihmës Sociale.

Ligji i Aplikueshëm:

Baza e kërkesëpadsisë,që e paditura të jetë përgjegjesë për ti kompenzuar paditësit gjenë mbeshtetje sipas Ligjit mbi shpalljen e ligjit mbi mardhenje të detyrimeve. aprovuar nga Kuvendi RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datën 30 mars 1978. Ku decidivishte e parashë se në bazë të neni 154,kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji.

Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj. Përgjegjësia e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organi i tij

Neni 172, Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkaktonte personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të veta. Në qoftë se në rastin e caktuar nuk është parashikuar diçka tjetër në ligj personi juridik ka të drejtë kompensimi nga personi që e ka fshehur dëmin me dashje ose nga pakujdesia e fundit.

Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe kompensimi në të holla Neni 185, Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla.

Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit.

Gjykata do të gjykojë dëmtuesit kompensimin në të holla kur ai e kërkon këtë me përjashtim kur rrethanat e rastit konkrete justifikojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme. Kur rrjedh për pagesë detyrimi i kompensimi Neni 186 Detyrimi i kompensimit të dëmit konsiderohet se rrjedh për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit. Kompensimi i dëmit në rast të lezionimit trupor ose të prishjes së shëndetit. Neni 195. Kush i shkaktonte tjetrit lezionim trupor, ose ia prish shëndetin ka për detyrë t'i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.

Në qoftë se i lezionuari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesëshme për punë e humbë fitimin, ose nevojat i janë shtuar vazhdimisht; apo mundësitë e zhvillimit të tij të mëtejshëm dhe, të përparimit janë zhdukuar ose janë pakësuar personi përgjegjës ka për detyrë ti paguajë të lezionuarit rentën e caktuar në të holla si kompensim për këtë dëm. Kompensimi në të holla, Neni 200, Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkëljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.

Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror. Në bazë të nenit 200 paragrafi 1 i LMD-së, parashihet që "Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkëljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.", ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh që "Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Sipas nenit 323 të LPK-së, është paraparë se "po qëse vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi në të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet

shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendos sipas çmuarjes së lirë të saj”.

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata pas analizimit të gjendjes faktike dhe juridike ka ardhur në përfundim se duhet të vendoset që të aprovohet pjesërisht padia dhe kërkesë padia si në pikën I dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Se më dt. 22/04/2010 paditësi kishte shkuar për kontrolla mjekësore në Q..... e M..... F..... në Deçan ku gjatë trajtimit mjekësor dhe dhënies se injeksionit nga ana e punëtores së paditurës kishte lënduar këmben e djathtë afër kukut duke shkaktuar lesion aksionar të nervit në këmben e djathtë. Këtë gjendje gjykata nxjerrur edhe me provën me ekspertizë nga të tre ekspert Dr. Flamur Blakaj, Dr. Naim Ukaj dhe Dr. Kamber Zeqiraj të cilët duke u bazuar në shkresat e lendes si dhe raportet nga Spitali Regjional i Pejës kishin deklaruar se paditësi në rastin e trajtimit në QKMF. Në konstatimin e tyre ndër tjera kanë deklaruar se nuk e përjashtojnë mundësin e shkaktimit të dëmtimit të nervit ishiadik pas dhënies së injeksionit, me pasojë parëzën e nervit peroneus të këmbës së djathtë dhe si i tillë ky dëmtim bënë pjesë në dëmtime të renda trupore.

Andaj gjykata ne tërësi ia fali besimin plotë të eksperteve ligjor të cilët në rastin e përpilimit të ekspertizës kanë përdorur metoda të avancuara për vlerësimin e lëndimit të paditësit. Andaj gjykata po ashtu në ekspertizën e të njëjtëve.Sa i përket natyrës se lëndimeve kishin konstatuar se: Dëmtim (PAREZE) i nervit peroneus të djathtë, i konstatuar që në raportin e parë të spitalit të Pejës me dt. 22/04/2010 dhe i konfirmuar EMG të vazhdueshme deri në raportin e fundit, dt.26/06/2023. Dëmtime të Renda trupore, jo të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit dhe me pasoja të përhershme të shëndetit. Në çastin e lëndimit, gjatë intervenimit mjekësorë, gjatë terapisë mjekësore dhe gjatë periudhës së përmisimit, i dëmtuari ka përjetuar këto dhimbje fizike: Intezitetit posaçërisht të lart prej ½ orëve, intezitetit të lartë 2 dit, intezitetit të mesëm 30 ditë, intezitetit i ulët ende her pas here. Të dëmtuarit i është dhuruar: Ndihma dhe kujdesi i personit tjetër 3 muaj, ushqimi i përforcuar 3 muaj, shërim klimatik-fizioterapeutik 80 dit. Shëmtim apo çrregullim (prishje) të aspektit estetik: Shkalla shumë e ulët.

Gjykata po ashtu e vlerësoj ekspertizën e eksperteve si të besueshme pasi që vlerësimi i tyre në rastin e lëndimit të paditësit kishin përdorur metodat me të avancuara të vlerësimit të lëndimeve të pësuar nga paditësi në këtë çështje.

Andaj gjykata ne rastin e vlerësimit të lartësisë sa i përket pika I, II vlerësoj se për të gjitha lëndimet si për dëmin material dhe jo material gjykata vlerësoj se i takojnë shpërblimi i dëmit si në dispozitiv në shumën prej Ne shumën totale prej 26500 (njetzet e gajstëmije e pesqindë euro). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi,

Gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave të aprovuara, në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarit – këtu paditësit, satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat materiale dhe jomateriale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën do ta kishte poqëse të njëjtat nuk do t'i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara,

intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, ku paditësi F.... O... ka përjetuar këto lëndime , ku gjykata murr parasysht të gjitha dhimbjet e pësuar trupore për të gjitha llojet ku lëndimit janë karakterit të lëndimeve të renda trupore , Në çastin e lëndimit , gjatë intervenimit mjekesorë , gjatë terapisë mjekesore dhe gjatë periudhës së përmisimit , i dëmtuari ka përjetuar këto dhimbje fizike : Intezitetit posaçërisht të lart prej ½ orëve , intezitetit të lartë 2 dit , intezitetit të mesëm 30 ditë , intezitetit i ulët ende her pas here .Të dëmtuarit i është duhur : Ndhima dhe kujdesi i personit tjetër 3 muaj , ushqimi i përforcuar 3 muaj , shërim klimatik-fizioterapeutik 80 dit .,Andaj gjykata duke u bazuar ne këto lëndime duke marrur parasysht edhe moshën e paditësit , gjendjen e tij shëndetësore dhe fizike gjykata vlerësojë se në rastin e vlerësimit të lartësisë , Kompensim (satisfaksion) ne emër te dhimbjeve trupore të përjetuara per të gjitha llojet, shumen prej 5100 euro (Pesmije e njeqindë euro).Kompensim (satisfaksion) për frikën për të gjitha llojet shumën prej 4900 (katërmijë e ntëqindë euro)Zhdëmtim (Satisfaksion) .

Gjykata vertëtoj se shëmtim trupor ekziston ne shkallë të lehtë, Shëmtim apo çrregullim (prishje) të aspektit estetik, Shkalla shumë e ulët. Gjykata vlerësoj se shuma e dëmit për shpërblim në emer të shëmtimit i takon në shumën prej 4.200 euro (katër mijë e dyqind euro).

Ndersa sa i përket zvogëlimi i aktiviteti jetësor ku ekspertet kanë konstatuar se pala paditese ka pësuar invaliditet përherëshëm shkallen prej 10%, Andaj gjykata duke marrur parasysht zvogëlimin ka caktuar shumën prej 4700 euro (katërmijë shtaqindë euro).

Gjykata po ashtu ne bazë të ekspertizës mjeko ligjore ka konstatuar se Ndhima dhe kujdesi i personit tjetër 3 muaj , ushqimi i përforcuar 3 muaj , shërim klimatik-fizioterapeutik 80 dit , për të kryer disa aktivitete përditshme jetësorë , i ndihmuar nga familjaret për shkake të lëndimit të kukut , po ashtu edhe për shpenzimet e shërimit në emer të ushqimit të përforcuar , gjykata vlerësoj se i takon shpërblimi prej në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 1100 (njëmijë e njeqindë euro),Shpenzimet për Shërim shumën prej 5400euro (pesmije e katërqindë euro),Në emër të Ndhmës së personit të tretë shumën prej 1100 euro (njëmijë e njeqindë euro).

Gjykata lidhur me pjesen e refuzuar si në pikën III të këtij aktgjykimi murr parasysht të gjitha rrethanat dhe erdh ne përfundim se shumat e aprovuara do të paraqesin satisfaksion real për palën e dëmtuar ne ketë aksident duke përfshirë të gjitha llojet e lëndimeve dhe frikës së përjetuar dhe shëmtimit,e përtej asaje shume,jan të pa a bazura dhe nuk gjejnë mbrojtje gjyqesore.

Gjykata murr parasysht edhe pretendimet e përf. të paditurës gjatë deklarimit të tije në përgjigje në padi si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, mirëpo nuk e murrën influencën që të vendoset ndryshe sepse baza juridike e shpërblimit të dëmit ishte nxjerrur nga të tre ekspertet ku kishin konstatuar se lëndimi ishte si pasoj e dhënies së injeksionit.Dhe për ketë është dënuar për përgjegjesin pënale sipas aktgjykimit të plotfuqishëm si në shkresa të lëndës. Andaj gjykata refuzoj pretendimet e paditurës në ketë seancë.

Gjykata lidhur me rentën jetësore për të ardhurat nga puna që ka mundur paditësit të cilën ekspertizë kishte përpiluar eksperti financiar i cili në konstatimin e tij kishte deklaruar se fitimin e humbur , renta e arritur periudhën 01/06/2014 deri me dt.31/12/2023 është 4,485.0 euro ,ndersa kamata ne rentën e arritur gjerë me dt.29/02/2024 është 1,794.75 euro ,në total shumën prej 6,279.73 euro .Renta e kapitalizuar për periudhën 01/01/2024-14/05/2061 është

7,812.58 euro , ndersa ne tërësi renta vijuese mujore në rast mos pagesës nder të tjera renta e kapitalizuar është 13.0 trembëdhjetë euro në muaj .në seancën e datës 20/03/2024 eksperti Ukë Sadiku ka mbetur pranë ekspertizës së përpiluar me shkrim. Gjykata e vlerësoj ekspertizën e cila ishte përpiluar në menyre profesionale duke përdorur metodat me të avancuara gjatë ekspertimit, mirëpo gjykata vlerësoj se ne bazë të ekspertizës së eksperteve mjekësor të cilët kishin konstatuar se paditesi nuk është tërësisht i pa aft për punë, por vetëm për disa punë specifike të cilat për shkak të lëndimit nuk mund ti kryej, si psh. Qëndrimi i tepërt në kembë, qëndrimi i tepërt ulur psh. Si taksist etj, mirëpo në asnjë vlerësim të tyre nuk kanë konstatuar se paditesi në tërësi është i pa aft për punë. Po ashtu gjykata ne bazë të shkresave të lendes prej momentit kur paditesi ka pasur probleme të tije e deri më sot nuk ka punuar askund , nuk ka provuar se paku të punojë ndonjë vend të caktuar , Nuk ka aplikuar ndonjë vend pune për të cilat ka mundur të ketë të ardhura nga puna për punët të cilat nuk i përket lëndimit të tije dhe zvogëlimit të aktivitetit të punës për disa punë të caktuara të cilat ka mundur ti kryej përkundër lëndimit të tij.dhe kur është cekur se për vitin e pare pas dëmtimit 30 % ku ne ketë periudhe ka qen i miture,ndersa pre vitin e dytë 20%,ku edhe për ketj periudhe ka qen i mitur,ndersa për për vitin e tretë pas dëmtimit 10%,e përfshin nje periudhe i mitur dhe madhore. Pra paditësi prej lëndimit të tije e gjerë me sot nuk ka provuar se ka punuar, apo ka vazhduar studime, për të cilin nuk ka mundur të punoje, apo diçka të ngjashëm, për ta bindur gjykatën me prova për këkres e kërkuar, dhe gjykata nuk ka mundur të vlerësoj se sa ka pësuar humbje kur i njëjti ska punuar asnjëherë dhe ka vendosur si në pikën III këtij Aktgjykimi

Lidhur me kamatën konform shumave të aprovuara për kompensim të dëmit material dhe Jo material gjykata ka vendosur duke u bazuar të Ligjit mbi shpalljen e ligjit mbi mardhenje të detyrimeve. aprovuar nga Kuvendi RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datën 30 mars 1978. Neni 399 të LMD-së,

ku thuhet se: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën si dhe lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (6%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material dhe jomaterial.dhe kerksa është se incidenti ka ndodhur ne vitin 2010 ather zbatohet ligji cekur me lartë e jo ligji i vit 2012.

Me rastin e vendosjes për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata ka vendosur konform dispozitave 449, 450 dhe 452 parg.1 të LPK-së ku thuhet se: “pala e cila humbë procesin gjyqësor ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq- fituese t’ ia shpërblej shpenzimet gjyqësore” dhe atë për padi 104 euro, për taks shumën prej 41 euro, për 7 seanca të mbajtura shumën nga 135 x14 gjithsejtë 2,160 euro, për tri ekspertiza ligjore prej 1,050 euro në total shumën prej 4,850.0 euro.

Nga sa u tha më lartë, e ne bazë të nenit 143, LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:909353
Datë: 06.05.2024
Numri i dokumentit: 05733196

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:909353, 06.05.2024

Gjyqtari
Fatmir Dobraj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, të këtij Aktgjykimi, e përmes kësaj Gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.